



Agjencia për Mbështetjen  
e Shoqërisë Civile

R  
A  
P  
O  
R  
T

V  
J  
E  
T  
O  
R

2  
0  
2  
3

**Të dhënat:**

Adresa: Rruga "Frosina Plaku", Nr. 58, Kati II, Tiranë

Kontakt: **04 223 5569**

<http://amshc.gov.al>

**AMSHC rezervon të drejtën e autorit për këtë material**

**Përdorimi i tij është i lejuar vetëm duke cituar burimin (AMSHC)**

## **FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV**

**Z.ANDI KANANAJ**

Të nderuar lexues, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Mbështetjes së Shoqërisë Civile, në bazë të kompetencave dhe detyrave që më janë caktuar si rrjedhojë e ligjit Nr.10 093, datë 9.3.2009 “*Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile*”, në vazhdimësi të ecurisë të punës së kryer gjatë vitit kalendarik 2023 dua të theksoj rritjen e rolit të shoqërisë civile si element kyç përsa i takon aplikimit të të disa të drejtave të njeriut që burojnë nga Kushtetuta apo akte të tjera ligjore. Gjatë këtij viti në bashkëveprim me disa prej aktorëve kryesorë të Shoqërisë Civile jemi përfshirë institucionalisht duke dhënë kontributin tonë në grupet e punës të ndërtuara me qëllim integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Me përafrimin e legjislacionit (*acquis*) në raport me normat ligjore të BE-së e ardhmja e Shoqërisë Civile premtan rritjen e rolit të kësaj të fundit si një element i domosdoshëm i shoqërive demokratike.

AMSHC krahas rolit të mësipërm në fokusin e saj ka pasur aplikimin e prioriteteve të paracaktuara dhe miratuara nga Bordi Mbikqyrës në fillim të vitit, që kanë ardhur si rezultat i konsultimeve publike të kryera, ndërmjet mbështetjes me grante të projekt-propozimeve të miratuara. Në terrenin ku shoqëria civile operon caktimi i prioriteteve ka synuar gjithmonë që rezultatet e aplikimit të projekt-propozimeve të sjellin në këmbim të mira në interes publik për grupe dhe kategori të caktuara.

Në përfundim inkurajoj të gjithë aktorët e shoqërisë civile (OJF-të, etj), të bashkëpunojnë me institucionin tonë për të bërë të mundur të gjithë së bashku krijimin e një habitati sa më të përshtatshëm dhe që do të shërbejë gjithmonë misionit për fuqëzimin e metejshëm të shoqërisë civile.

**Me respekt,**

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Andi KANANAJ**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>KAPITULLI I.....</b>	
▪ Vështrim i përgjithshëm .....	fq 3
▪ Organet dhe funksionet e institucionit .....	fq 4
▪ Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMSHC-së.....	fq 5
<b>KAPITULLI II .....</b>	
▪ Zbatimi i Ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" , Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”... si dhe Strategjisë Kundër Korrupsionit.....	fq 6-7
▪ Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 16 sipas fushave prioritarë si dhe shtrirjes territoriale.....	fq 8-12
▪ Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese .....	fq 12-14
<b>KAPITULLI III .....</b>	
▪ Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC).....	fq 15-16
<b>KAPITULLI IV.....</b>	
▪ Monitorimi/Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetore për Vitin 2023 .....	fq 17
▪ Plani fillestar i Buxhetit Viti 2023 .....	fq 18
▪ Rishikimi i Buxhetit.....	fq 18-19
▪ Vitin 2023 si dhe ndryshimet e ndodhura nga plani fillestar .....	fq 19-20
▪ Analiza e realizimit të treguesve buxhetorë për Vitin 2023.....	fq 20-27
<b>KAPITULLI V .....</b>	
▪ Aktivitetet kryesore të AMSHC-së për vitin 2023.....	fq 27-44
<b>KAPITULLI VI.....</b>	
▪ Bordi Mbikqyrës dhe vendimarrja e tij.....	fq 44-45

## KAPITULLI I

### Vështrim i përgjithshëm

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është një ent publik, buxhetor krijuar me Ligjin me nr. 10093 datë 09.03.2009 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”*.

AMSHC është krijuar me qëllimin për të asistuar me Mbështetje Financiare dhe Teknike Shoqërinë Civile në vend duke qenë e përkushtuar të promovojë, mbështesë dhe mbrojë parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, mos-diskriminimit, sundimit të ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, transparencës dhe profesionalizmit.

Një shoqëri civile aktive, e fuqishme dhe gjithë përfshirëse mund të luajë një rol të rëndësishëm për zbatimin në praktikë të këtyre parimeve. Ajo është gjithashtu një komponent thelbësor i çdo demokracie funksionale.

Duke artikuluar shqetësimet e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile, si subjekte jo- shtetërore, struktura jo-fitimprurëse, në të cilat njerëzit organizohen të ndjekin objektivat dhe idealet e përbashkëta, duhet të jenë gjithnjë e më shumë aktive për çështje publike si dhe të angazhohen në iniciativa që nxisin pluralizmin dhe pjesëmarrjen në demokraci.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në kuadër të politikës së fuqizimit të shoqërisë civile, është përqendruar në stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe gjithë përfshirëse.

Kjo reflektohet në përpjekjet për krijimin e një mjedisi që është i favorshëm për aktivitetet e shoqërisë civile dhe ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve për të qenë aktorë të efektshëm, të përgjegjshëm dhe të pavarur, nëpërmjet formalizimit të procedurave transparente dhe jo- diskriminuese të regjistrimit, veprimtarisë së lirë dhe të pavarur, si dhe bashkëpunimit midis qytetarëve etj.

Shoqëria civile, duke pasur struktura të përshtatshme dhe mekanizma për bashkëpunim me AMSHC-në dhe institucionet e tjera publike, si dhe fluks të lirë, të qartë dhe të arritshme të informacionit mbi çështjet e interesit publik përmes mekanizmave të qëndrueshme dhe të strukturuar, rrit autonominë e saj, atë të përfaqësimit dhe të llogaridhënies, duke forcuar bazën e organizatave sipas standardeve më të larta të qeverisjes së brendshme, nëpërmjet përfshirjes së strukturave demokratike, monitorimit dhe vlerësimit, menaxhimit financiar, transparencës, informimit dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë.

## **Organet dhe funksionet e institucionit**

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është krijuar me Ligjin nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe ka si mision të saj, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për përmbushjen e këtij misioni, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si detyrë të saj funksionale që të ofrojë asistencë financiare dhe teknike për programet që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndër-sektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropi, vullnetarizmin e institucioneve demokratike të shoqërisë civile, si dhe programe të tjera, që lehtësojë përmbushjen e misionit të saj.

### **Agjencia Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si objekt të veprimtarisë së saj:**

- *nxitjen e bashkëpunimi me OJF-të, që kanë objekt të punës mbikëqyrjen e luftës kundër korrupsionit; luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të trajtimit të viktimave të saj; kundër dhunës në familje e kundër dhunës ndaj fëmijëve;*
- *nxitjen e qytetarëve në veprimtari, përfshirja e pjesëmarrja e tyre për zhvillimin e komunitetit;*
- *respektimin e të drejtave të njeriut;*
- *krijimin e konsolidimin e kapaciteteve të shoqërisë civile;*
- *zhvillimin e bashkëpunimit ndër sektorial dhe e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile;*
- *rritjen e ndikimit publik dhe veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile në vendimmarrje;*
- *zhvillimin e sipërmarrjes shoqërore dhe punësimit në sektorin jofitimprurës;*
- *rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike*
- *përcaktimin e procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile etj.*

## Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMSHC-së

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile funksionon dhe mbështet punën e saj duke u bazuar në një paketë të plotë ligjore, si më poshtë vijon:

- *Ligji me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ky ligj, deri më sot nuk ka pësuar asnjë ndryshim.*
- *Vendimi nr. 769 datë 15.07.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.*
- *Vendimi nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.*
- *Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 20.09.2010.*
- *Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e azhurnuar në përrputhje dhe përshtatje me ndryshimet e parashikuara në Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Këto ndryshime janë miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 30.11.2011.*
- *Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile” të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës me Vendimin nr. 1 datë 08.07.2010.*
- *Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile”, e ndryshuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 10.03.2011.*
- *Vendimi nr. 1 datë 08.07.2010 i Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, nëpërmjet të cilit janë miratuar:*
  - *Formati i Aplikimit.*
  - *Kriteret e Vlerësimit.*
  - *Kontrata Tip*
- *Udhëzimin nr. 1 datë 29.12.2010 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për plotësimin e raporteve financiare dhe kontrollin financiar, për efekt të monitorimit të Projekteve të financuara me Grante nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.*
- *Urdhri nr. 161 datë 05.09.2013 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për procedurën e administrimit të akteve shkresore, kërkesave/projekt-propozimeve, formimin e dosjeve dhe mënyra e qarkullimit të tyre në AMSHC”;*

*\*Shënim: AMSHC gjatë kryerjes së detyrave të caktuara nga ligjet në fuqi për përmbushje sa më të plotë të të drejtave të qyteatarëve/subjekteve aplikon dhe ligje apo akte nënligjore që nuk janë të përmendura më sipër rast pas rasti.*

## KAPITULLI II

### STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015 – 2023

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), është pjesë e zbatimit të Objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 – 2023

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) AMSHC- ja ka fut si prioritet të dedikuar Prioritetin : **Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI: (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit që do shpërndahet).**

Ky prioritet është në kuadër pikërisht në kuadër të detyrimeve që vijnë nga marrveshjet ndër-institucionale të tilla si Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

Zbatimi i Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe i Ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"

Në përputhje me nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*" është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile.

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës AMSHC ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, duke mundësuar aksesin e të drejtës për informim në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet [Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile | Faqja Zyrtare \(amshc.gov.al\)](http://Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile | Faqja Zyrtare (amshc.gov.al)).

Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje.

Faqja zyrtare e AMSHC-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve / subjekteve të të dhënave, etj.

Zbatimi i Ligjit Nr. 146/2014 "*Për njoftimin dhe konsultimin publik*"

Takime informuese dhe konsultime publike me OShC-të lidhur me çështjet:1

Në Qaret kryesore të vendit lidhur me:

- Mbi procesin e përcaktimit të prioritetëve të Thirrjes nr. 16 për Projekt-Propozime;
- Mbi procesin e përzgjedhjes së katër anëtarëve të rinj të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile;
- Në kuadër të bashkërendimit të punës së AMSHC-së me Planin Kombëtar të Veprimit, 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur; Feedback-u i marr nëpërmjet Pyetësorit tematik të plotësuar online, (rreth 50 organizata të shoqërisë civile) si dhe nga nje pjesë e tyre e shpërndarë në takimin konsultativ të organizuar në dt. 10.01.2023; me tematikën të "Mbi procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024";

❖ **Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 16 sipas fushave prioritare si dhe shtrirjes territoriale**

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut; shpalli këtë Thirrje për Shprehje Interesi; Thirrjen e rradhës për të gjitha OJF-të e interesuara për projekte.

**Prioritet e përcaktuara nga Bordi Mbikqyës për Thirrjen Nr.16 ishin si më poshtë:**

**1. Shërbimet Sociale dhe Rinia:**

- Realizimi i Shërbime psiko- sociale në kuadër të rritjes së kujdesit për grupet në nevojë (të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar etj), si dhe çështjet e përfaqësimit të minoriteteve (romë, egjyptian, LGBT, etj);
- Nxitja dhe fuqizimi i vullnetarizmit;
- Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, aktivizim i tyre në proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia si dhe nxitja dhe krijimi i hapsirave të nevojshme për punësimin e tyre;
- Përmirësimi i shërbimeve sociale, mbështetje për moshën e tretë;
- Ofrimi i asistencës së nevojshme për gratë e dhunuara si dhe gratë- viktimat të trafikimit;

**2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI: (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit që do shpërndahet)**



Ky prioritet është në kuadër të detyrimeve që vijnë nga marrveshjet ndër-institucionale të tilla si Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

- Në fushën e Prokurimeve;
- Në fushën e Arsimit;
- Në fushën e Shëndetësisë dhe
- Zbatimit të Ligjit;
- E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjëve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike;

### **3. Mjedi, Mbrojtja dhe Projekte të lidhura me të:**

- Mbrojtja, rehabilitimi i mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij;
- Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit;
- Nxitja e nismave kulturore dhe artistike brenda/dhe për komunitetet;
- Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore;

### **4. Arsimi, Integrimi European dhe Politikbërja:**

- Sensibilizim, fuqizim kapacitetesh për një mjedis mundësues në proceset integruese;
- Integrimi evropian, njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar si dhe integrimi në tregun e punës;
- Prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;
- Përfshirja e Organizatave në Politikbërja si pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit *për Partneritet për Qeverisje të Hapur*;

**Shuma maksimale e financimit me grant për projekt-propozimet ka qenë 2 (dy) milionë lekë.**

### **Statistika lidhur me Nr. total të Projekteve Propozimeve të ardhura si dhe shpërndarja e tyre sipas secilës fushë prioritare:**

Në Thirrjen 16 për Projekt-Propozime kanë aplikuar rreth 141 OJF- aplikante ndër këto Bordi Mbikëqyrës ka shpallur si fitues 65 Projekt- propozime;

Shpërndarja e Projekt-Propozimeve të cilat kanë Aplikuar për financim; sipas fushave prioritare paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Fushat Prioritare/Priority Fields	Nr Projektev e aplikuese	Shuma e kërkuar nga AMSHC-ja per secilën fushë Prioritare
1	<p><b><u>1. Shërbimet Sociale dhe Rinia:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Realizimi i Shërbime psiko- sociale në kuadër të rritjes së kujdesit për grupet në nevojë (të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar etj), si dhe çështjet e përfaqësimit të minoriteteve (romë, egjyptian, LGBT, etj);</li> <li>Nxitja dhe fuqizimi i vullnetarizmit;</li> <li>Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, aktivizim i tyre në proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia si dhe nxitja dhe krijimi i hapsirave të nevojshme për punësimin</li> <li>e tyre;</li> <li>Përmirësimi i shërbimeve sociale, mbështetje për moshën e tretë;</li> <li>Ofrimi i asistencës së nevojshme për gratë e dhunuara si dhe gratë- viktima të trafikimit;</li> </ul>	42	80,929,025
2	<p><b><u>2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI: (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit që do shpërndahet)</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ky prioritet është në kuadër të detyrimeve që vijnë nga marrveshjet ndër-institucionale të tilla si Strategjia Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit, Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;</li> <li>Në fushën e Prokurimeve;</li> <li>Në fushën e Arsimit;</li> <li>Në fushën e Shëndetësisë dhe Zbatimit të Ligjit;</li> <li>E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjëve në</li> <li>qeverisje, transparencë e institucioneve publike;</li> </ul>	28	53,776,490
3	<p><b><u>3. Mjedis, Mbrojtja dhe Projekte të lidhura me të:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbrojtja, rehabilitimi i mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij;</li> <li>Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit;</li> <li>Nxitja e nisimave kulturore dhe artistike brenda/dhe per komunitetet;</li> <li>Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore;</li> </ul>	42	78,098,145
	<p><b><u>4. Arsimi, Integrimi European dhe Politikbërja:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Sensibilizim, fuqizim kapacitetesh për një mjedis mundësues në proceset integruese;</li> </ul>		


4	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Integrimi evropian, njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar si dhe integrimi në tregun e punës;</li> <li>• Prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;</li> <li>• Përfshirja e Organizatave në Politikbërja si pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit <i>për Partneritet për Qeverisje të Hapur</i>;</li> </ul>	19	52,334,961
5	me shume se nje fushe prioritare	10	18028142
Total		141	283,166,763

**Shpërndarja e Projekteve fituese sipas Fushave Prioritare për projektet fituese Thirrja NR. 16 Për Projekt-propozime (27 Mars – 27 Prill 2023) paraqitet sipas Tabelave/grafikut të mëposhtëm:**

Nr.	Fushat Prioritare/Priority Fields	Nr. Projekteve	Shuma e financuar per secilin prioriteteve	Pesha Spcifike ne %/ In Percantage %
1	<p><b><u>1. Shërbimet Sociale dhe Rinia:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Realizimi i Shërbime psiko- sociale në kuadër të rritjes së kujdesit për grupet në nevojë (të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar etj), si dhe çështjet e përfaqësimit të minoriteteve (romë, egjyptian, LGBT, etj);</li> <li>Nxitja dhe fuqizimi i vullnetarizmit;</li> <li>Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, aktivizim i tyre në proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia si dhe nxitja dhe krijimi i hapsirave të nevojshme për punësimin e tyre;</li> <li>Përmirësimi i shërbimeve sociale, mbështetje për moshën e tretë;</li> <li>Ofrimi i asisitencës së nevojshme për gratë e dhunuara si dhe gratë- viktima të trafikimit;</li> </ul>	21	30,400,000	31.6
2	<p><b><u>2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI: (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit që do shpërndahet)</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ky prioritet është në kuadër të detyrimeve që vijnë nga marrveshjet ndër-institucionale të tilla si Strategjia Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit, Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;</li> <li>Në fushën e Prokurimeve;</li> <li>Në fushën e Arsimit;</li> <li>Në fushën e Shëndetësisë dhe</li> </ul>	14	24,200,000	25.2

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimit të Ligjit;</li> <li>E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjëve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike;</li> </ul>			
3	<p><b><u>3. Mjediti, Mbrojtja dhe Projekte të lidhura me të:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbrojtja, rehabilitimi i mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij;</li> <li>Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit;</li> <li>Nxitja e nismave kulturore dhe artistike brenda/dhe për komunitetet;</li> <li>Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore;</li> </ul>	20	27,700,000	28.8
4	<p><b><u>4. Arsimi, Integrimi European dhe Politikbërja:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Sensibilizim, fuqizim kapacitetesh për një mjedis mundësues në proceset integruese;</li> <li>Integrimi evropian, njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar si dhe integrimi në tregun e punës;</li> <li>Prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;</li> <li>Përfshirja e Organizatave në Politikbërja si pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit <i>për Partneritet për Qeverisje të Hapur</i>;</li> </ul>	7	10,400,000	10.8
5	me shume se nje fushe prioritare	3	3,500,000	3.6
Total		65	96,200,000	100.0

Grafiku 1



**Siç mund të vërehet nga tabela dhe grafiku, prioriteti me përqindjen më të lartë të projekteve të zbatuara është ai nën fushën Prioritare: Shërbimet Sociale dhe Rinia; me një peshë specifike 31.6%**

**4. Një zë tjetër i rëndësishëm i përqindjes së peshës specifike përbën Prioriteti Mjedisi, Mbrojtja dhe Projekte të lidhura me të:**

- ✓ Mbrojtja, rehabilitimi i mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij;
- ✓ Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit;
- ✓ Nxitja e nismave kulturore dhe artistike brenda/dhe per komunitetet;
- ✓ Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore; me 28.8%

**Ndërkaq edhe Prioriteti “Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI”: ( si detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit që do shpërndahet) zë një peshë specifike të rëndësishme prej 25.2%**

Ndërkaq, kategoria më shumë se një prioritet / fushë; në përgjithësi nga statistikat ka qenë një kategori që gjithnjë ka pasur një përqindje të lartë, pasi projektet kanë qenë të një natyre më të

gjerë, por që për këtë thirrje kjo kategori është në përqindjedje më të ulur krahasimisht me vitet e tjera. Pra projektet kanë qenë më të orientuar në një prioritet të caktuar.

**Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese**

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në mënyrë të vazhdueshme duke qenë se në filozofinë e saj e misionin e saj ka një shpërndarje të projekteve fituese sa më të gjerë në të gjithë territorin.

Në të njëjtën përjasje edhe në thirrjen e saj Nr. 16 të drejtuar OJF-ve për shprehje interesi për Projekt Propozime e ka pasur si objektiv kryesor një shpërndarje territoriale sa më të gjerë në nivel kombëtar.


Në mënyrë më të detajuar për këtë shpërndarje të dhënat shprehen në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm:

Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e Projekteve fiuese:

Nr.	Shtrirja në Nivel Qarku	Shpërndarrja e Projekteve sipas Qarqeve
1	Qarku i Beratit	3
2	Qarku Dibër	3
3	Qarku Durrës	4
4	Qarku Elbasan	8
5	Qarku Fier	5
6	Qarku Gjirokastrë	2
7	Qarku i Korçë	4
8	Qarku Kukës	2
9	Qarku Lezhë	2
10	Qarku Shkodër	3
11	Qarku Tiranë	14
12	Qarku Vlorë	4
<b>13</b>	<b>Projekte në Nivel Kombëtar</b>	<b>11</b>
<b>65 Projekte ne Total / 11 nga te cilet ne nivel Kombetar /15 projekte mbulojne me shume se nje qark</b>		

**GRAFIK:**

Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese për Thirrjen 16



Ndërkaq kjo shpërndarje gjeografike e projekteve fituese sipas qyteteve të secilit Qark Administrativ paraqitet sipas tabelës së mëposhme:

Nr	Qarku	Nr i Projekteve	Nr i Projekteve në nivel Qarku për secilin qytet	
1	Qarku Berat	3	Berat	3
			Kuçovë	0
			Skrapar	0
2	Qarku Dibër	3	Dibër	1
			Bulqizë	2
			Mat	0
3	Qarku Durrës	4	Durrës	3
			Krujë	1
4	Qarku Elbasan	8	Elbasan	4
			Gramsh	2
			Librazhd	1
			Peqin	1
5	Qarku Fier	5	Fier	3
			Lushnjë	2
			Mallakastër	0



6	Qarku	2	Gjirokastrë	2
	Gjirokastrës		Permet	0
			Tepelenë	0
7	Qarku Korçë	4	Korçë	2
			Devoll	1
			Pogradec	1
			Kolonjë	0
8	Qarku Kukës	2	Kukës	1
			Tropojë	1
			Has	
9	Qarku Lezhë	2	Lezhë	1
			Kurbini	0
			Mirditë	1
10	Qarku Shkodër	3	Shkodër	2
			Pukë	1
			Malsisë së Madhe	
11	Qarku Tiranë	14	Tiranë	12
			Kamëz	1
			Vorë	0
			Kavajë	1
12	Qarku Vlorë	4	Vlorë	2
			Sarandë	1
			Delvinë	0
			Himare	1
13	Projekte në Nivel/Rang Kombëtar		11	

Siç mund të vihet re nga të dhënat tabelave/grafikëve si dhe shpërndarjes në përqindje; por edhe asaj territoriale, Projektet fituese kanë një përqëndim më të lartë të zbatueshmërisë në rrethin e Tiranës.

Mbulimi për financim me projekte në përgjithësi prek të gjitha qarqet administrative. Mbulimin me përqindje më të lartë siç u përmend dhe më lartë e zë Qarku i Tiranës, më pas vijnë qarqet Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Durrës, Korçë etj.



REPUBLICA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

### KAPITULLI III

#### KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE (KKSHC)

Referuar nevojave dhe synimit për përafrimin e legjislacionit në fuqi por jo vetëm, edhe strukturave shtetërore për funksionim edhe më të saktë të shoqërisë civile, Qeveria Shqiptare ndërmorri iniciativën për themelimin dhe organizimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Misioni themelor i këtij Këshilli do të jetë garantimi i bashkëpunimit institucional me organizatat eshoqërisë civile në dobi dhe në funksion të zgjerimit të demokracisë.

Në vazhden e kësaj nisme, Qeveria Shqiptare, në fundvitin e 2015-ës, miratoi Ligjin Nr. 119/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.

#### **Veprimtaria dhe aktivitetet e KKSHC-së për periudhën Janar 2023 - Dhjetor 2023**

AMSHC, në cilësinë e sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, gjatë vitit 2023 ka mbështetur organizimin e Takimit Kombëtar të Shoqërisë Civile më 24 Prill 2023, dhe të dy mbledhjeve pasuese të Këshillit Kombëtar, përkatësisht më 19 Qershor dhe 16 Nëntor 2023.

#### **a) Takimi Kombëtar i Shoqërisë Civile, Tiranë 24 Prill 2023**

Rreth 80 (tetëdhjetë) organizata të shoqërisë civile në rang kombëtar u mbledhën në Tiranë me qëllim identifikimin e sfidave të organizatave të shoqërisë civile, dhe hartimin e rekomandimeve që mund të nxisin zhvillimin e qendrueshëm të saj si edhe përfshirjen e shoqërisë civile në strategjitë zhvillimore në fushën ekonomike, sociale, integrimin evropian, respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në vend.

#### **Rekomandimet kryesore të dala prej takimit kombëtar ishin:**

1. Futja e shërbimeve të OJF-ve në skemën e dëmshpërblimeve nga dëmet e tërmetit.
2. Të rishikohet ligji për regjistrimin e OJF-ve, i cili është i pazbatueshëm, shumë burrokratik, dhe jo fleksibël.

3. Organizatat e shërbimeve të mos trajtohen si biznes edhe në procedurë prokurimi.
4. Pushteti vendor të sigurojë lehtësi për mjedise pune për OJF-të lokale (p.sh financim për infrastrukturë). Qeverisja vendore të jetë pjesë e KKShC; Komunikim dhe konsultim me qeverisjen vendore/të jetë pjesë e mbledhjeve Agjencia e Pushtetit Vendor.
5. Kujdestaria për aftësinë e kufizuar duhet të njihet si vite pune.
6. Të shqyrtohet nga AMSHC mundësia e një fushate komunikimi për të reklamuar KKShC-në dhe rolin që anëtarët e shoqërisë civile në Këshill mund të kenë për rekomandimin e politikave. Të shtohet gjithashtu roli mbështetës që AMSHC ka si sekretariat i KKShC-së.
7. Mjedisi ligjor të jetë lehtësues dhe mbështetës në lidhje me taksimin, sponsorizimet, gjobat, dhe mbështetjet financiare.

### **b) Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile – 19 Qershor 2023**

Në mbledhjen e 19 Qershorit u prezantuan dhe diskutuan gjerësisht çështjet e mëposhtme:

1. Prezantimi i procesit të zgjedhjeve dhe zyrtarizimi i anëtarëve të rinj përfaqësues të shoqërisë civile në Këshill.
2. Prezantime dhe diskutime mbi përmbledhjen e gjetjeve dhe arritjeve nga takimi kombëtar i shoqërisë civile të mbajtur më 24.04.2023
3. Hartimi i kalendarit mbi proceset e hartimit të Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile - dhe miratimi i tij.
4. Prezantimi i draftit të Udhërrëfyesit për Funksonimin e Institucioneve Demokratike.
5. Diskutim i problemeve fiskale të organizatave të shoqërisë civile
6. Zgjedhja e përfaqësuesit nga KKSHC në Komitetin Ndërmintor për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm dhe zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qendrueshëm.

### **Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile – 16 Nëntor 2023**

Në mbledhjen e 16 Nëntorit u bë prezantimi zyrtar i Kryetares së re të Këshillit Kombëtar, Ministres së Shëndetësisë, Znj. Albana Koçiu me anëtarët e tjerë të Këshillit, përfaqësues të shoqërisë civile. Përgjatë takimit Kryetarja u prezantua me punën bërë nga Këshilli, veçanërisht nga anëtarët e shoqërisë civile në Këshill, si edhe u diskutua mbi vizionin strategjik dhe çështjet specifike që priten të trajtohen në mbledhjet në vazhdim.

### **Lista e përmbajtjes së Raportit të Monitorimit Financiar**

- 1- Hytje
- 2- Plani fillestar i Buxhetit Viti 2023
- 3- Rishikimi i Buxhetit për Vitin 2023 nëpërmjet Akteve Normative dhe shkresave specifikisht për rishikimet e buxhetit për nevojat e Institucionit dhe mbarëvajtjes së punës
- 4- Rishikimi i Buxhetit në zbatim të VKM –së për rritjen e pagave për Administratën për Vitin 2023.
- 4- Analiza e realizimit të treguesve buxhetore/financiare për Vitin 2023

## **HYRJE**

*Në mbështetje të nenit 104 pika 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit Nr.84/2022 “Për Buxhetin e Vitit 2023” në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, ju dërgojmë Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për Agjencinë për Mbështetje të Shoqërisë Civile për Vitin 2023.*

### **1- Monitorim/ Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetore për Vitin 2023**

Siç edhe dihet, Monitorimi në këtë rast është një proces vlerësimi performance buxhetore i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Pra, monitorimi buxhetor është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Me anë të këtij raporti monitorimi të Buxhetit të AMSHC - së për Vitin 2023, saktësojmë informacionin mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për Vitin 2023 përsa i përket **Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile**.

Në përdorimin e fondeve buxhetore, AMSHC –ja është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor.

Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat ekonomike dhe prioritetet e AMSHC –së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara nga Agjencia për Mbështetje të Shoqërisë Civile për vitin 2023.


### **2- Plani fillestar i Buxhetit Viti 2023**

Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, *në mbështetje të Ligjit Nr.84/2022 “Për Buxhetin e Vitit 2023”* në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, i është akorduar një fond i planifikuar prej **123,805,000 mije lekë**, i detajuar si më poshtë (Tab.Nr.1) nga:

**Plani fillestar i Buxhetit Viti 2023**

**Tab.Nr.1**

Fondi i Pagave (zëri 600)	15,370,000	Lekë
Fondi i Sigurimeve Shoqërore (zëri 601)	2,735,000	Lekë
Fondi për Shpenzime Operative (zëri 602)	4,700,000	Lekë
Fondi për transfertat ndaj të tretëve (zëri 604)	100,000,000	Lekë
Fondi për Investimet e Trupëzuara (zëri 231)	1,000,000	Lekë
	123,805,000	Lekë



Duke vlerësuar konstatimet dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave përsa i përket Përgatitjes së Fazës së Parë të PBA –së 2024-2026, vlerësojmë se Ekipi i Menaxhimit të Programit gjatë vitit 2023, ka bërë një punë të përgjegjshme në drejtim të respektimit të përcaktimeve të udhëzimit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm përshtatur specifikisht për natyrën e detyrave dhe përgjegjësiqe që AMSHC mbulon në bazë të Ligjit mbi të cilin është krijuar dhe funksionon që prej vitit 2019.

- **Së pari**, në kuadër të pikës 3 të Udhëzimit nr.10, dt.28.02.2017 “Përfshirja e shoqërisë Civile në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”, ju vemë në dijeni se pjese e planeve të punës në baza vjetore për AMSHC- në, është gjithmonë realizimi I takimeve

konsultative me përfaqësues të Shoqërisë Civile në Shqipëri me qëllim njohjen me problematikat e hasura, me sygjerimet e tyre lidhur me organizimin e punës në Institucion, sugjerimet e tyre përsa i përket detajimit të zërave buxhetore si dhe përsa i përket aktiviteteve që janë të rëndësishme për t'u organizuar me qëllim përcjelljen e

“feedback” të qartë të OJF-ve në punën tonë të përditshme si Institucion që mbështet fuqizimin e një Shoqërie Civile të qënësishme në vend.

- **Së dyti**, në vijim të punës për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor, edhe AMSHC -ja përcaktuar produkte/objektiva/aktivitete/kosto të detajuara për arritjen e barazisë gjinore si dhe ka financuar dhe ndjekur projekte me këtë qëllim.

**3- Rishikimi i Buxhetit per Vitin 2023 si dhe ndryshimet e ndodhura nga plani fillestar i Buxhetit në zbatim të VKM-së nr. nr,325, dt.31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nënpunësve civilë dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike”,!**

Mbështetur në Ligjin Nr.84/2022 “Për Buxhetin e Vitit 2023” në zbatim të Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 9.01.2023 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2023" si dhe për zbatimin e VKM –së nr.325, dt.31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nënpunësve civilë dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike”, Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile ka pasur nevojë për një rialokim fondi në llogarine 600 dhe 601 për të bërë të mundur zbatimin e VKM-së së pagave nga fondi i kontigjencës sic përcaktohet në këtë VKM sipas tabelës së rialokimeve të fondeve bashkëngjitur dhe pjesë e kësaj shkrese (**Tab.Nr.1**).

**Tab ne Leke**

Ent,Qeverisje	Min Linjes	Kod Institucioni	Emër Institucioni	Kapitulli	Programi	Llog.Ekonomike	Kod Produkti	Kod Thesari	Shuma
<b>SHTOHET</b>									
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	600	98801AA	3535	2,950,000
<b>SHTOHET</b>									
01	81	1088001	AMSHC	01	01110	601	98801AA	3535	250,000

Ndërkohë, për arsye të vazhdimësisë së monitorimeve në terren të projekteve të cilat financohen nga AMSHC –ja dhe nisur nga udhëtimet e punës të realizuara përgjatë Vitit 2023 për dhe me qëllim Rritjen e pjesëmarrjes së OShC-ve në menaxhimin e instrumentit të para-aderimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit; Koordinimin e financimeve dhe Programeve të BE prej të cilave mund të përfitojë shoqëria civile; etj, lindi nevoja për një rialokim fondi mes llogarive të AMSHC –së, më konkretisht fondi prej 2,000,000 kaloi nga llogaria e granteve 604 te llogaria e shërbimeve dhe mallrave 602 te Kodi 98801AB, fond i cili është përdorur kryesisht për mbulimin e shpenzimeve me karakter “*monitorim/vlerësim në terren të projekteve financiar nga AMSHC*”, si dhe për mbulimin e eventeve me qëllim rritje kapacitetesh teknike të OJF -ve si pjesë e qëllimit afatgjatë të punës së AMSHC- së, si edhe për *arritjen e objektivave si Institucion në një moment kaq të rëndësishëm për vendin tonë dhe procesin e Integritimit në BE, ku përfshirja e OSHC –ve është tejet e rëndësishme !*

Gjithashtu, është shtuar në llogarinë 606 fondi prej 550,780 lekësh fond i cili është vënë në përdorim për stafin e AMSHC- së sipas legjislacionit që rregullon këtë pjesë, në zbatim të VKM –së nr.795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të Qeverisjes Qëndrore në procesin e shyrimit analitik të Acquis (Screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”.

➤ **Rialokimi i fondeve për efekt të shpërblimit të stafit sipas VKM –së nr.795, datë 28.12.2023**

Viti 2023

Tab ne  
Leke

Ent.Qeverisje	Mi n Linj es	Kod Institucioni	Emer Instituci oni	Kapitulli	Programi	Llog.Ekonomike	Kod Thesari	Shuma
<b>SHTOHET</b>								
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	6060000	3535	550,780
<b>PAKESOHET</b>								
01	81	1081003	Fond i I veçan te	01	04950	6090000	3535	550,780

➤ **Rialokim fondi në llogarinë e shërbimeve/mallrave 602 Kodi 98801AB**

Viti 2023

Tab ne Leke

	Mi n Linj es	Kod Institucio ni	Emer Institucio ni	Kapitull i	Programi	Llog.Ekonomike	Kod Thesari	Shuma
<b>SHTOHET</b>								
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	604	3535	2,000,000
<b>PAKESOHET</b>								
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	602/Produkti 98801AB	3535	2,000,000
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	601	3535	2,000,000



**Pas ndryshimeve të kërkuar Plani i buxhetit përfundimtar për AMSHC –në për vitin**

**2023 është si më poshtë :**

**Plani i Buxhetit përfundimtar për AMShC-në – Viti 2023 pas ndryshimeve të ndodhura përgjatë vitit 2023**

<b>Fondi i Pagave (zëri 600)</b>	<b>18,320,000</b>	<b>Lekë</b>
<b>Fondi i Sigurimeve Shoqërore (zëri 601)</b>	<b>2,985,000</b>	<b>Lekë</b>
<b>Fondi për Shpenzime Operative (zëri 602)</b>	<b>6,700,000</b>	<b>Lekë</b>
<b>Fondi për transfertat ndaj të tretëve (zëri 604)</b>	<b>98,000,000</b>	<b>Lekë</b>
<b>Fondi për Transferta Familjare dhe Individët (zëri 606) /Fondi I vecante</b>	<b>550,780</b>	<b>Lekë</b>
<b>Fondi për Investimet e Trupëzuara (zëri 231)</b>	<b>1,000,000</b>	<b>Lekë</b>
		<b>Lekë</b>

Mbi detajimin e buxhetit të këtij viti duhet theksuar detajimi në dy produkte të buxhetit akorduar AMSHC –së, të tilla si 98801AA si dhe 98801AB ku produktet të parashikuara në PBA e Vitit 2023 sipas formateve të reja kanë qenë dy të tilla si : Projekte të financuara nga AMSHC –ja si dhe Monitorime/Inspektime ne terren.

➤ **Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile**

<b>Ecuria e realizimit buxhetor per Vitin 2023</b>			
<b>Struktura Buxhetore</b>	<b>Shpenzimet Progresive Fakt</b>	<b>Plani Vjetor sipas ndryshimeve të bera gjate vitit</b>	<b>Realizimi ne Përqindje</b>
600 - Llogaria e pagave	18,238,093	18,320,000	99 %
601 - Kontribute sig shoq shend	2,940,642	2,985,000	98 %
602 - Shpenzime te tjera Korrente	5,831,995	6,700,000	87 %
604/1 - Tranferta GRANTE	97,913,721	98,000,000	99 %

231 - Investimet te brendshme	492,118	1,000,000	49 %
-------------------------------	---------	-----------	------

606- transfertat familjare dhe individët	515, 120	<b>550,780</b>	93 %
<b>Totali</b>	<b>125,416,569</b>	<b>127,555,780</b>	98 %

**4- Analiza e realizimit te treguesve buxhetore per Vitin 2023**

**Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore** (zeri 600-601), është **realizuar** në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar me Vendim nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ndryshuar me Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, Ligjin Nr.84/2022 “Për Buxhetin e Vitit 2023”, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, sipas Vendimit Nr.56, dt. 01.02.2023 “Për Përcaktimin e numrit të Punonjësve me kontratë të përkohshme për Vitin 2023 në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, numri mesatar i punonjësve për AMSHC -në është realizuar 16 punonjës të përhershëm si dhe dy punonjës me kontratë të përkohshme.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, gjatë këtij viti, është realizuar respektivisht;

- **18,238,093 Lekë** (zeri 600) për paga, realizimi **99 %**.
- **2,940,642 Lekë** (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore shëndetsore, realizimi **98 %**.
- Shpenzimet e Personelit janë realizuar në vlerën **21,178,735 lekë në total dhe 98% me përqindje** që do të thote që është një realizim shumë i mirë i fondit të pagave dhe sigurimeve për Vitin 2023 duke përshtatur edhe rritjen e pagave dhe përditësimin e klasave të pagave sipas VKM -së nr.325, dt.31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nënpunësve civilë dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike”.

**Fondi për shpenzime të tjera korrente** (zeri 602), për vitin 2023, është planifikuar fillimisht me Ligjin e Buxhetit të Vitit 2023 në vlerën **4,700,000 leke**.

Në këtë zë buxhetor është mbështetur edhe veprimtaria dhe aktivitetet e KKSHC- së nisur edhe nga detyrat që AMSHC –ja ka përmbushur si Sekretariat i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile duke mbuluar aktivitetet e KKSHC –së si dhe për të siguruar facilitetet logjistike për organizimin e mbledhjeve të KKSHC –së. Për këtë arsye është mbështetur financiarisht Konferenca e KKSHC-së realizuar në Vitin 2023.

Ofrimi i asistencës ligjore në finalizimin e Udhërrëfyesit për Shoqërinë Civile ku AMSHC ndërmori një rol të rëndësishëm në hartimin dhe mirëpërcaktimin e planit të punës dhe më gjerë. Për këtë funksion, AMSHC gjithashtu ndërmori një sërë masash me qëllim realizimin sa më të saktë të tij duke përthithur produktin final (miratimin dhe zbatimin e Udhërrëfyesit). Në kuadër

të zbatimit të këtij Udhërrëfyese të rishikuar, janë specifikuar detyrat për çdo Institucion dhe aktorë të Shoqërisë Civile të përfshirë. AMSHC –ja së bashku me Kryeministrinë ka edhe detyrën e rëndësishme të monitorimit të zbatimit të Udhërrëfyesit për një mjedis mundësues të Shoqërisë Civile si mekanizmi dhe plani kryesor i punës për të lehtësuar dhe mundësuar aktivitetin e OJF- ve në vend.

Roli aktiv i AMShC- së në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit është një tjetër arritje e Institucionit duke ndikuar sadopak në plotësimin e masave dhe indikatorëve sa i përket Qasjes Ndërgjegjësuese. Për këtë qëllim, AMShC ka tashmë programin e saj Institucional kundër Korrupsionit, një buxhet të dedikuar për projektet anti- korrupsion. Në zërin buxhetor të AMSHC –së , disa shpenzime janë dedikuar edhe kësaj strategjie.

Pas rialokimeve te fondit per llogari te zerit 602 Totali i këtij zëri përgjatë vitit ishte **6,700,000 leke.**

Edhe për këtë zë, për gjatë vitit 2023 është realizuar vlera prej **5,831,995 Lekë** ose **87 %** e planit vjetor të rishikuar për AMSHC –në,.

Një arsye tjetër për këtë rezultat fakt të shpenzimeve të zërit shpenzime, mirëmbajtje llogaria 602 janë edhe procedurat e prokurimeve online ku është synuar gjithmonë për çmimin më të ulët për blerjet në kuadër të logjistikës së përgjithshme për ecurinë normale të punës në Institucion në zbatim të Ligjit të Prokurimeve në fuqi.

Në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC –ja është mbështetur në parimin e një shpërndarje sa më racionale të kërkesave për ecurinë optimale të veprimtarisë së Institucionit si dhe ka zbatuar “*Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike per Vitin 2023*” per blerje dhe shërbime të cilat kryesisht lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevoja të AMSHC-së, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, lyerje dhe mirembajtje, pastrim etj.
- Kryerjen e pagesave per likuidimin e detyrimeve furnitorë dhe të tretë etj.
- Kryerjen e monitorimeve në terren të projekteve që AMSHC ka financuar gjatë vitit 2023.
- Realizimin e study - tour në vende të rajonit për shkëmbimin e eksperiencave më të mira për zhvillimin dhe mbështetjen e shoqërisë civile.

Realizimi i fondit për Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes në vlerën 87% argumentohet me arsyet si me poshtë vijon:

- Së pari, gjatë vitit 2023 janë realizuar pjesa më e madhe e praktikave te prokurimeve të parashikuara në Rregjistrin e Prokurimeve Publike dhe gjithashtu janë realizuar programet e punës përse i përket monitorimeve në terren të projekteve qe AMSHC – ja ka financuar dhe monitoruar gjatë vitit 2023 duke zbatuar legjislacionin përse i

takon Urdhër shërbimeve dhe Udhëtimeve të punës me qëllim monitorimin në terren të projekteve të OJF-ve financuar nga AMSHC –ja.

**Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme** (zeri 604), për vitin 2023 është planifikuar në vlerën **100,000,000 leke**.

Ky është dhe zëri më me peshë në strukturën e buxhetit të AMSHC- së, duke qene se dhe vete Misioni i këtij Institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet e OJF përfituese.

Edhe për këtë zë, aktualisht **604 Kapitulli 1** për periudhën respektive është realizuar vlera prej **97,913,721 Lekë** ose **99 % e planit vjetor**.

Ndërkohë disbursimet e zërit të Granteve kanë përfshirë disbursime nga Thirrja Nr.15, dhe në gjysmën e dytë të Vitit fiskal 2023 janë disbursuar Projektet fituese të Thirrjes Nr.16 organizuar nga AMSHC-ja të cilat janë aktualisht në zhvillim dhe pritet të përfundojnë përgjatë vitit 2024.

**Fondi per shpenzim investime** (zeri 231),

**1,000,000 Lekë** (zeri 231) për Investime të Trupëzuara,

Gjatë tre mujorit të katërt të vitit 2023, janë finalizuar edhe praktikrat e prokurimit dhe ndjekjes përse i përket fondit të investimeve. Në total për këtë zë janë disbursuar **492,118 leke që përbëjnë 49% të fondit të Investimeve**.

Pjesa e parealizuar e fondit të Investimeve arsyetohet me ndjekjen e procedurave online të Prokurimeve publike dhe lidhjes së kontratave me çmimin më të ulët. Investimet këtë vit kanë shkuar për përmirësimin e rrjetit të IT –së në Institucion, për përmirësimin e gjendjes së ambienteve të brendshme të zyrave etj.

AMSHC është një Institucion qendror buxhetor i krijuar me Ligjin Nr. 10093 Date 09.03.2009 **“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”** dhe VKM Nr. 769 Date 15.07.2009 “Per Miratimin e Statutit te AMSHC-se” (I ndryshuar), me Mision themelor **“Nxitjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shoqërisë Civile”**, si dhe **“Krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile”**, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për realizimin e Misionit, AMSHC-ja ofron **“asistencë financiare”** për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera si

trajnime/ëorkshops/konferenca/takime rajonale që lehtësojnë përmbushjen e misionit të saj.

Duke filluar nga **muaji Nëntor 2010 e deri në fund të vitit 2023** Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile udhëhequr nga Bordi Mbikqyrës I AMSHC- së, ka organizuar **16 Thirrje për ProjektPropozime** sipas prioriteteve dhe fushave të cilat janë objektiva të përhershëm të Institucionit, dhe janë kryer procedurat e duhura konform Ligjeve në fuqi në lidhje me njoftimin, shpalljen, vlerësimin, seleksionimin dhe kontraktimin e Organizatave Jofitimprurëse për financimin me Grante të projekteve që kanë rezultuar fituese. Më tej puna konkrete e AMSHC- së si Institucion, mbetet ndjekja e Projekteve deri ne fazën finale të realizimit të tyre, Monitorimi dhe Vlerësimi I ecurisë së realizimit të Aktiviteteve konform projektpropozimit dhe kontratës së lidhur mes palëve si dhe Monitorimi dhe Vlerësimi I ecurisë së realizimit

financiar të Projekteve të financuara nga AMSHC- ja dhe përputhshmëria me buxhetin e parashikuar si dhe me legjislacionin fiskal dhe tatimor të Republikës së Shqipërisë. Sasia e granteve dhe Organizatave Jofitimprurëse të kontraktuara për t’u Financuar për secilën Thirrje të organizuar nga AMSHC paraqitet si vijon:

Tabela 4 (ne Leke):

Thirrja	Numri i OJF-ve Perfituese	Vlere e Granteve financiare (ne Leke)
Thirrje Nr.1	52	125,918,000
Thirrje Nr.2	31	16,000,000
Thirrje Nr.3	69	131,960,000
Thirrje Nr.4	63	62,105,000
Thirrje Nr.5	47	55,200,000
Thirrje Nr.6	21	43,755,840
Thirrje Nr.7	41	73,500,000
Thirrje Nr.8	18	36,000,000
Thirrje Nr.9	41	85,200,000
Thirrje Nr.10	35	95,100,000
Thirrje Nr.11	45	107,700,000
Thirrja Nr.12	52	115,600,000
Thirrja Nr.13	46	41,230,000
Thirrja Nr.14	72	108,650,000
Thirrja Nr.15	62	95,500,000
Thirrja Nr.16	63	95,500,000
<b>TOTAL</b>	<b>758</b>	<b>1,193,418,840</b>

Puna kryesore e AMSHC- së për Vitin 2023 është përqendruar në realizimin me sukses të Thirrjeve për Projekt-Propozime si dhe ndjekjes/Monitorimit/Vlerësimit të projekteve të zbatuara në kuadër të këtyre Thirrjeve.

Aktualisht, mund të themi se AMSHC në fund të vitit 2023, ka lidhur kontrata për realizimin e 758 projekteve të Shoqërisë Civile në një vlerë totale prej rreth 12 milion euro, duke e fokusuar punën në monitorimet në terren dhe me bazë dokumnetacioni të këtyre projekteve të cilat janë nisma civile dhe projekte dedikuar grupeve vulnerabël të shoqërisë.

Fushat prioritare të shpërndarjes së fondeve për Vitin 2023 për Thirrjen për Projektpropozime paraqiten si më poshtë vijon:

**THIRRJE NR. 16 PËR PROJEKTE (27 Mars – 27 Prill 2023)**

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), në kuadrin e konkurrimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut ka shpallur Thirrjen për Shprehje Interesi për të gjitha OJF-të e interesuara për projekte.

**Janë ftuar të gjitha OJF-të e interesuara të sjellin projekt-propozime që kanë si objekt dhe mbulojnë fushën prioritare:**

**1. Shërbimet Sociale dhe Rinia:**

- Realizimi i Shërbime psiko- sociale në kuadër të rritjes së kujdesit për grupet në nevojë (të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar etj), si dhe çështjet e përfaqësimit të minoriteteve (romë, egjyptian, LGBT, etj);
- Nxitja dhe fuqizimi i vullnetarizmit;
- Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, aktivizim i tyre në proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia si dhe nxitja dhe krijimi i hapsirave të nevojshme për punësimin e tyre;
- Përmirësimi i shërbimeve sociale, mbështetje për moshën e tretë;
- Ofrimi i asistencës së nevojshme për gratë e dhunuara si dhe gratë- viktimat të trafikimit;

**2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI: (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit që do shpërndahet)**

Ky prioritet është në kuadër të detyrimeve që vijnë nga marrveshjet ndër-institucionale të tilla si Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

- Në fushën e Prokurimeve;
- Në fushën e Arsimit;
- Në fushën e Shëndetësisë dhe
- Zbatimit të Ligjit;
- E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjëve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike;

**3. Mjedis, Mbrojtja dhe Projekte të lidhura me të:**

- Mbrojtja, rehabilitimi i mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij;
- Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit;
- Nxitja e nismave kulturore dhe artistike brenda/dhe për komunitetet;
- Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore;

**4. Arsimi, Integrimi Europian dhe Politikbërja:**

- Sensibilizim, fuqizim kapacitetesh për një mjedis mundësues në proceset integruese;
- Integrimi evropian, njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar si dhe integrimi në tregun e punës;
- Prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;



- Përfshirja e Organizatave në Politikbërja si pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit *për Partneritet për Qeverisje të Hapur*;
- **Shuma maksimale e financimit me grant për projekt është deri në 2 (dy) milionë lekë.**

**Projekt-propozimet duhet të shoqërohen me dokumentet e mëposhtme (dokumentat që janë pjesë e pandashme e aplikimit):**

1. **Formulari i plotësuar i aplikimit**, i vulosur dhe i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i Organizatës (Formulari duhet firmosur në çdo faqe);
2. Fotokopje të **Vendimit të Regjistrimit të Gjykatës dhe Statutit të Organizatës**;
3. **Ekstrakti i Gjykatës** (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Qarkut, Tiranë)- origjinal brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
4. **NIPT-i** (i noterizuar) brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
5. **Vërtetim nga Drejtoria e Tatim Taksave** (që Organizata nuk ka detyrime të pashlyera përse u përket kontributeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore) – origjinal ose me vulë digjitale (i shkarkuar nga shërbimi [ëëë.e-albania.al](http://ëëë.e-albania.al)) brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
6. **Vërtetim bankar** (ku pasqyrohen numri IBAN dhe numri i llogarisë së Organizatës, në lekë) – brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
7. **CV të Organizatës** (të firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesi ligjor i OJF-së) dhe Licencën e lëshuar nga autoritetet publike në rast se ka aktivitetete të parashikuara në projekt, të cilat nuk mund të kryhen pa zotëruar Licencën përkatëse (për shembull: në rastet kur projekt-propozimet kanë aktivitetete që kërkojnë ekspertizën e psikologut, ky i fundit duhet të ketë licensë për të kryer këtë funksion);
8. **Deklaratë/Marrëveshje Partneriteti** (origjinale ose fotokopje të noterizuar, në rast se ka partneritet në këtë projekt-propozim);

## KAPITULLI V

### VEPRIMTARIT E SEKTORIT – ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE, BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR DHE KOMUNIKIMIT

Aktivite kryesore të zhvilluara përgjatë 2023 nga AMSHC-ja janë si mëposhtë vijon:

Në datën 28/12/2023 Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në bashkëpunim me organizatën Advenio e-Academy, Cardet, SOS Malta dhe Miqtë e Korçës, ka zhvilluar ceremonin e shpërndarjes së certifikatave pranë Ambjenteve të AMShC-së.

Ky program kishte si qëllim që të siguronte thellimin e njohurive të organizatave Jofitimprurëse për t'i ndihmuar ato në forcimin e aftësive dhe kompetencave të tyre.

Ky program do t'u mundësojë OJF-ve të përmirësojnë dhe zhvillojnë kapacitetet e tyre menaxhuese, të rrisin ndikimin e tyre social, të arrijnë qëllimet e tyre dhe të jenë të qëndrueshme me kalimin e kohës.

Në përfundim të trajnimit katër përfaqësues organizatash nga Shoqëria Civile u pajisen me certifikatë për të gjitha modulet, por gjithashtu organizatorët menduan që t'ju japin një certifikatë për pjesëmarrje në kurs edhe disa personave të tjerë të cilët kanë realizuar një pjesë të provimeve për disa nga modulet.



### FOTO ILUSTRUESE E AKTIVITETIT

Në përfundim të programit  #AkademiaeOJF-ve2023 e organizuar nga Partenrs Albania, AMSHC në mbështetje të nismave për zhvillimin e Shoqërisë Civile, zhvilloi takimin e rradhës në ambjete të saj me qëllim rritjen e dialogut dhe partneritetit me organizatat pjesëmarrëse në #Akademi.

- Takimet kontribuan në njohjen e rolit të këtyre institucioneve në mbështetje të organizatave të shoqërisë civile dhe veprimtarisë së tyre.
- Zhvillimi i bashkëpunimit ndërsektorial dhe i bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile; Rritja e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike, skema të mbështetjes financiare për OJF-të, e të tjera çështje u diskutuan gjatë vizitës pranë Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile – AMSHC
- Shoqëria civile është një aktor i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, duke treguar prej vitësh angazhim dhe vendosmëri në këtë drejtim.



**Disa prej veprimtarive të zhvilluara nga Organizatat fituese të Thirrjes Nr. 16 pranë Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC):**

Qendra “Youth Act” në kuadër të projektit “Youth Net-Zgjidh Vetën” i financuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), ka realizuar aktivitetin “Shërbime këshillimi psiko- social për të rinjtë” në qytetin e Tiranës, Durrësit dhe Beratit.

Gjatë këtyre aktiviteteve, 150 të rinjve i’u ofrua mundësia të marrin këshillim psiko –social nga këshillues profesionist. Ekspert të fushës shpjeguan se çfarë është shëndeti mendor, pse është e rëndësishme të flitet për të si dhe mënyrat për ta parandaluar. Gjithashtu u informuan mbi mënyrat e promovimit të shëndetit të mirë mendor. Broshura informuese u shpërndan me qëllim këshillimin mbi shëndetin mendor e atë emocional.





FOTO ILUSTRUESE E AKTIVITETEVE



### FOTO ILUSTRUESE E AKTIVITETIT

“Centre for Legal Empowerment” me mbështetjen e Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile - AMSHC, ofron ndihmë dhe shërbime ligjore për të garantuar aksesin e qytetarëve në drejtësi, nëpërmjet platformës [www.Juristionline.al](http://www.Juristionline.al).

Qytetarët mund të këshillohen dhe informohen lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas legjislacionit në fuqi, metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje organet publike ose në kuadër të marrëdhënieve me personat juridikë dhe fizikë privatë, etj.

Juristët e platformës janë në shërbim të qytetarëve në çdo orë të ditës.

Me mbështetjen e Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile - AMSHC, CLE ka publikuar përmbledhjen ligjore me pyetjen më të shpeshtë të Platformës JuristOnline.

“ EU Policy Hub/Forumi i Politikave të Integritit” ka nisur të zbatojë projektin Klubi Rinor i Integritit European në Qytetin Tim dhe në kuadër të tij shpall thirrjen për aplikime në Shkollën e Integritit European.

Në këtë shkollë të rinjtë e moshës 18-29 vjeç do të kenë mundësinë të zgjerojnë dijet e tyre mbi strukturën dhe institucionet e Bashkimit European, politikat kryesore të BE-së, kostot dhe përfitimet që vijnë nga procesi i anëtarësimit Shqipërisë në BE, me synim nxitjen e një mbështetjeje më të lartë të të rinjve mbi këtë perspektivë strategjike.

Janë ftuar të gjithë të rinjtë që duan të përmirësojnë njohuritë e tyre mbi politikat e BE-së dhe procesin e anëtarësimit të Shqipërisë të shprehin interes për tu bërë pjesë e kësaj Shkolle duke dërguar një Letër Motivimi dhe CV në adresën e emailit: [info@eupolicyhub.eu](mailto:info@eupolicyhub.eu) deri në datën 30 Nëntor, 2023!

Qëllimi i projektit ka qënë rritja e ndërgjegjësimit, informimi dhe komunikimi i procesit të integritit european tek të rinjtë për ti shndërruar ata në faktor advokues për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.



#### FOTO ILUSTRUESE E AKTIVITETIT

Në kuadër të projektit [#RinAkt](#) të mbështetur financiarisht nga [Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile - AMSHC](#) dhe zbatuar nga [AlbanianSkills](#) në bashkëpunim të ngushtë me Bashkia Peqin, të rinjtë e Peqinit kanë ndërmarrë një sërë hapash për realizimin e nismave që lidhen me zgjidhjen e disa problematikave në këtë qytet, duke planifikuar disa aktivitete, siç është dhe ai me datë 17.11.2023.

👉 Nën vazhdën e hapave për realizimin e nismave, të rinjtë e Bashkisë Peqin së bashku me aktivisten dhe mësimdhënësen Silva Sufali dhe nën kujdesin e Kryetarit të Bashkisë Peqin kanë ndërmarrë një marshim ndërjegjësuës dhe një aksion pastrimi në Pyllin me Pisha 🌲 për të tërhequr vëmendjen e gjithë komunitetit dhe pushtetit lokal për një qytet dhe mjedis më të pastër dhe të gjelbër. 🌿

👉 Ky marshim u zhvillua përgjatë fashës orare 11:00-13:30. Vendi i takimit ishte Pallati i Kulturës, Peqin e marshimi do të vijonte drejt Pyllit me Pisha.



**amshc**  
Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

**albanianskills**  
We promote skills

## PASTRIMI I QYTETIT DHE PYLLIT TË PEQINIT.

Mjedisi ynë është burimi që është shumë i rëndësishëm për të gjithë ne. Pyjet, lumenjtë, oqeanet dhe tokat tona na ofrojnë ushqimin që hamë, ajrin që thithim, ujin me të cilin ujitim të korrat tona.

Nismë e të rinjve Bashkia Peqin në kuadër të projektit Rini Aktive (RIN'AKT) me mbështetjen financiare të Agjencisë për Shoqërinë Civile në Shqipëri zbatuar nga Albanian Skills dhe mbështetjen e Bashkisë Peqin.

### RËNDËSIA E PASTRIMIT TË ZONAVE TË QYTETIT DHE PYLLIT TË PISHAVE:

- **PASTRIMI NDIKON DREJTPËRDREJT NË SHËNDETIN E BANORËVE DUKE REDUKTUAR TRANSMETIMIN E SËMUNDJEVE.**
- **NJË QYTET I PASTËR TËRHEQ EDHE TURISTË DHE INVESTIME, DUKE KONTRIBUAR NË RRITJEN EKONOMIKE.**
- **RUAJTJA E PASTËRTISË DUHET TË JETË NJË PËRGJEGJËSI KOLEKTIVE, DUKE PËRFSHIRË ORGANET KOMUNALE DHE QYTETARËT E SAJ.**

**TË DHËNAT PËR DITËN KUSHTUAR PASTRIMIT TË QYTETIT DHE PYLLIT TË PISHAVE TË PEQINIT**

**LUTEMI TË MERRNI PJESË EDHE JU NE NISMËN TONË KUSHTUAR MJEDISIT TË PËRBASHKËT / KONTRIBUO SOT, PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRE NESËRI**

**REDUCE REUSE RECYCLE**

**RIN'AKT**

**GLASS PAPER PLASTIC BOTTLES**


**Data: 17.11.2023**  
**Dita: E Premte**  
**Vendi i nisjes: Pylli i pishave**  
**Ora: 11.30 AM**

"Ky publikim, është mundësuar me mbështetjen financiare të AMSHC-së. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i AMSHC-së".

### FOTO ILUSTRUESE

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile-AMSHC ka mbështetur Shoqatën "OrArt" në realizimin performances me fabula për Shtepinë e fëmijes Shkodër. Ky është i dyti vit që AMSHC i bashkohet këtij misioni për të përcjell edikim nëpërmjet artit.





#### FOTO ILUSTRUESE E AKTIVITETIT

Më datë 13.10.2023, pranë ambienteve të Qendrës Komunitare [@teqendrojmesebashku](#), nisi rrugëtimi i trajnimeve të Qendrës "ALTERUM", në kuadër të projektit "Edukimi, Informimi dhe Stimulimi i Fëmijëve për Mbrojtjen dhe Ndërveprimin me Mjedisin". Së bashku me fëmijët e kësaj qendre gjatë trajnimit u simulua edhe ndarja mbeturinave për riciklim.

Qendra "ALTERUM", vendosi ta mbylli rrugëtimin e këtij projekti, pikërisht atje ku u nis, duke dhuruar për Qendrën Komunitare "Të qëndrojmë së bashku", tre kosha për ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve.

Të gjitha nryshimet e mëdha, fillojnë të marrin jetë nga gjeste të vogla. Mbështetja e shoqërisë civile në nisma për angazhimin e brezit të ri në mbrojtjen e mjedisit, është jetike për një shoqëri të shëndetshme dhe që kërkon të evoluojë.

Ky projekt u realizua me mbështetjen financiare të [Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile - AMSHC](#).



Të rinjtë dhe përdorimi i drogave!

Të rinjtë, sot më shumë se kurrë kanë nevojë për informacione të sakta që lidhen me sjelljet me risk, përdorimi i drogave dhe alkoolit dhe promovimi i sjelljeve të shëndetshme.

Punë e përditshme e [Aksion Plus](#) janë takimet me të rinj për të ofruar sa më shumë informacione të sakta në lidhje me fenomenin e përdorimit të substancave dhe sjelljeve të rrezikshme.

Këto aktivitete realizohen në kuadër të projektit ‘Shërbime Efektive për Individët Përdorues të Drogave’ dhe mbështeten nga [Agjencia për Mbeshtetjen e Shoqërisë Civile - AMSHC](#).



## FOTO ILUSTRUESE E AKTIVITETIT

**AMSHC mbështet promovimin e aktiviteteve në mbështetje financiare dhe logjistike kundrejt cdo nisme për Shoqërinë Civile.**

Projekti rajonal WeBER 3.0 - “Fuqizimi i Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar” zbatuar në Republikën e Shqipërisë nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ka pasur si qëllim të fuqizojë më tej OSHC-të në drejtim të kontributit për të pasur administrata publike më transparente në Ballkanin Perëndimor, të hapura, llogaridhënëse për qytetarët dhe rrjedhimisht në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Projekti shpall thirrjen për instrumentin e granteve të vogla. Propozimet do të duhet të identifikojnë probleme specifike të qeverisjes vendore ose të administratës publike vendore, me synim zgjidhjen e tyre.

Thirrja për propozime është në vlerë të përgjithshme prej 280.000 EUR dhe ka si qëllim të mbështesë deri në 20 grante në Ballkanin Perëndimor, me vlerë deri në 14,000 euro secili. Nga to, do të financohen deri në 3 (tri) projekte në Shqipëri. Kohëzgjatja e projekt propozimeve do

të jetë deri në 15 muaj.

Thirrja e plotë për aplikim dhe të gjitha dokumentet përkatëse kanë qënë në dispozicion për shkarkim në [whttps://idmalbania.org/.../thirrje-per-aplikime-weber-3.../](https://idmalbania.org/.../thirrje-per-aplikime-weber-3.../)

Afati i pranimit të propozimeve ka qënë: 29 shtator 2023 deri më 28 dhjetor 2023.

Sesioni i informimit për këtë thirrje do të mbahet në ZOOM, në datë 18 tetor 2023, nga ora 15:00 – 16:15, sipas agjendës së bashkëngjitur.

Regjistrimi paraprak i pjesëmarrjes në sesionin informues bëhet në <https://us02web.zoom.us/.../tZ0vd...>

Projekti WeBER 3.0 është i financuar nga Bashkimi Evropian, përfaqësuar nga Komisioni Evropian dhe i bashkëfinancuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim.

### **Disa prej veprimtarive të zhvilluara nga Organizatat fituese të Thirrjes Nr. 16 pranë Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC):**

📍 Albania SHAH-MAT!

🎯 Projekti “ALBANIA SHAH – MAT” suvenir risjellë në një format të ri lojën e Shahut, dizajnin e setit të shahut, gurët e të cilit do të realizohet me imazhin e simboleve të marra nga objekte të Trashëgimisë Kulturore të Shqipërisë, si një mundësi e shkëlqyer për të promovuar përmes lojës së shahut jo vetëm Trashëgiminë Kulturore të Shqipërisë dhe Simbolet e saj, objekte arkitektonike, historike, kulturore, artistike, por edhe për të promovuar fuqizimin e industrisë kreative, përdorimin e teknologjisë dhe teknikave të reja kreative të kohës nëpërmjet dizenjës industriale.

- ✅ Projekti u realizua nga Shoqata **Ks Factor** me mbështetje financiare nga **Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile - AMSHC**



### **FOTO ILUSTRUESE**

SCI çmon rëndësinë e njohjes së Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm nga të rinjtë, si kontribues të drejtpërdrejtë tek e ardhmja.



Kjo video është realizuar në kuadër të projektit "Rajoni dhe BE-ja në Shtëpinë Tonë! - Përfshirja e të rinjve beratas në proceset e integritit rajonal dhe në BE" me mbështetjen financiare të [Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile - AMSHC](#).

SCI mbështet të rinjtë dhe përkrah edukimin e tyre mbi proceset e integritit ekonomik rajonal si edhe njohjen me procesin e integritit të Shqipërisë në BE si përfitues të drejtpërdrejtë nga ky proces.

Kjo video është realizuar në kuadër të projektit "Rajoni dhe BE-ja në Shtëpinë Tonë! - Përfshirja e të rinjve beratas në proceset e integritit rajonal dhe në BE" me mbështetjen financiare të [Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile - AMSHC](#).



◆ Vullnetarizmi është esenca e punës së ACMS. Për rrjedhojë ndikimi i vullnetarizmit rinor në ndryshimet frymëzuese në shoqëri ka një rëndësi maksimale në punën tone të përditshme. Kjo vjen si pasojë e nevojave që shoqëria jonë ka për një komunitet të rinjsh aktiv në të gjitha sferat e jetës.

◆ ACMS me mbështetjen e [Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile - AMSHC](#) nis zbatimin e projektit me titull “Ndikimi i të Rinjve: Ndryshime frymëzuese përmes vullnetarizmit”.

◆ Ky projekt zbatohet në kuadër të prioritetit të parë të thirrjes, Shërbimet sociale dhe Rinia.

◆ Projekti do të zhvillojë një fushatë sensibilizimi në rrjetet sociale si dhe një trajnim 4 ditor me 30 të rinj ku do të trajtohet tema e vullnetarizmit dhe rëndësia e tij, me metoda të edukimit joformal.

◆ Ky projekt synon gjithashtu të inkurajojë dhe t'i bëjë të rinjtë të aftë për t'i trajtuar problemet e tyre në mënyrë efikase dhe këmbëngulëse.

◆ Stay tuned për më tepër mbi projektin dhe rrugëtimin e të rinjve që do të jenë pjesë e tij.

📍 Kamëz, Shqipëri.



### FOTO ILUSTRUESE

Ka nisur implementimi i projektit më të ri të Përtej Barrierave “Rritja e kapaciteteve për vullnetarizëm të qëndrueshëm”, financuar nga [Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile - AMSHC](#) në Shqipëri.

📌 Qëllimi kryesor i këtij projekti është krijimi i një mjedisi mundësues përmes ngritjes së kapaciteteve të ofruesve të vullnetarizmit, promovimit të tij si një mjet për qytetari aktive dhe solidaritet, si dhe inkurajimi i aktorëve kyç për të bashkëpunuar në përmirësimin e kuadrit ligjor të vullnetarizmit në Shqipëri.

🌟 Gjatë muajit korrik kemi kryer sesionin informues me 25 të rinj në kuadër të fushatës promovuese dedikuar vlerave dhe benefiteve të vullnetarizmit.

Pjesëmarrës ishin jo vetëm të rinj lokalë të interesuar, por edhe disa të rinj pjesë e rrjetit të vullnetarëve të BBA prej vitesh, si edhe 3 vullnetarët tanë ndërkombëtarë të programit European Solidarity Corps 🇪🇺, për të ndarë së bashku eksperiencat me vullnetarizmin, si edhe për të diskutuar mbi rritjen e kapaciteteve dhe kontributin shoqëror, si rezultat i pjesëmarrjes në aktivitete vullnetare. 🗣️



Qendra RIAS organizon

Projektin "Gjon Mili Jazz&Blues Festival", Edicioni II, i cili synon promovimin e figurës së Gjon Milit, si e vetmja urë lidhëse që kombi shqiptar ka me historinë botërore të muzikës Jazz dhe Blues, duke e bërë pjesë të Trashëgimisë Kulturore dhe Artistike të Shqipërisë.

Objektivat kryesore me anë të të cilave synohet përmbushja e qëllimit të këtij projekti janë:

1. Njohja dhe promovimi i figurës së Gjon Milit si vlerë e trashëgimisë kulturore. Gjon Mili, nëpërmjet filmave "Jammin' the blues", "Stompin' for Mili", "Improvisation" dhe veprave fotografike, ka dokumentuar artistikisht rëndësinë e muzikës Jazz për fuqizimin e integritimit kulturor dhe emancipimit social.
2. Promovimi dhe zhvillimi i muzikës Jazz dhe Blues në Shqipëri nëpërmjet koncerteve të festivalit, jamsession, masterklaseve dhe vënia në pah e lidhjes që Gjon Mili kishte me muzikën Jazz gjatë moderimit të festivalit.
3. Përpunimi dhe realizimi i 45 veprave muzikore Jazz dhe Blues (të njohura dhe krijimtari të reja); Element i rëndësishëm do të jetë integrimi i muzikës tradicionale shqiptare me muzikën Jazz.
4. Rritje artistike, shkëmbim eskperiencash dhe kulturor të muzikantëve të rinj shqiptarë dhe ndërkombëtarë, nëpërmjet Masterklaseve dhe Jam Session për muzikën Jazz dhe Blues.
5. Nxitja dhe rritja e veprimtarisë profesionale dhe artistike të muzikantëve të rinj të huaj dhe shqiptarë nëpërmjet performancës në rrymën Jazz dhe Blues (grupet e festivalit janë: 2 grupe nga Shqipëria, 1 grup nga Kosova, 1 grup nga Maqedonia, 1 grup nga Italia dhe 1 grup nga Austria);





👉 Takimet e OJF-ve pjesëmarrëse në programin e Partners Albania vijuan me vizita pranë [Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile - AMSHC](#)

📌 Zhvillimi i bashkëpunimit ndërsektorial dhe i bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile; rritja e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike, skema të mbështetjes financiare për OJF-të, e të tjera çështje u diskutuan



**NJOFTIM PËR KANDIDIM PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARIT TË BORDIT MBIKËQYRËS TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE (AMSHC) :**

Në mbështetje të ligjit nr.10093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, dhe të vendimit nr.768, datë 15.7.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave e të rregullave për kandidimin dhe për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, AMSHC shpalli njoftimin për kandidim për një anëtar të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Konkurrimi është i hapur për përfaqësues që i përkasin shoqërisë civile.

Afati i dorëzimit të aplikimit, ishte deri më 25 shtator 2023.

Adresa: Kryeministria

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.1. 1000

Tiranë, Shqipëri

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

tel: 04 22 77 401

**Në 19 Qershor 2023 u mbajt mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), në ambientet e Kryeministrisë.**

👉 Çështjet kryesore të paraqitura dhe të diskutuara ishin gjetjet dhe sugjerimet kryesore që dolën nga organizatat e shoqërisë civile gjatë takimit kombëtar me Shoqërinë Civile më 24 prill 2023 në Tiranë.

👉 Temat e tjera të prezantuara kishin të bënin me draft dokumentin e ri të Udhërrëfyesit dhe afatin kohor të këtij procesi.

Në fund të takimit, Këshilli zgjodhi një përfaqësues nga shoqëria civile, i cili do ta përfaqësojë atë në Komitetin Ndërministror për SDGs 2030.





✦ Shoqëria civile është një aktor i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, duke treguar prej vitësh angazhim dhe vendosmëri në këtë drejtim. Përfaqësues së [Qendra ALTRI](#) diskutuan me pjesëmarrësit rëndësinë e 🗣️ bashkëpunimit me median për t'u dhënë 🗣️ zë për përpjekjeve advokuese të OJF-ve, dhe ndër të tjera ndanë disa arritje nga puna kërkimore mbi 🗣️ çështjet gjyqësore penale dhe civile me palë gazetare dhe/ose përfaqësues të medias në kuadër të garantimit të një politike të tolerancës zero për frikësimin dhe sulmet ndaj gazetarëve.

Instituti Shqiptar për Çështjet Publike - AIPA, në kuadër të projektit “Për një Mjedis dhe Zhvillim të qëndrueshëm: Mendo SAFE - Organizo SAFE - Vepro SAFE”, ka vijuar me zhvillimin e fushatës informuese në shkollën e mesme “Hermann Gmeiner”.

Përgjatë orës se hapur informuese dhe ndërjegjësuere, nxënësit e këtij gjimnazi janë informuar lidhur me rëndësinë e parandalimit të krizave dhe emergjencave civile dhe natyrore, sidomos të atyre që shkaktohen nga vetë dora e njeriut. Gjithashtu, Eksperti i kontraktuar nga AIPA z. Demir Osmani ka ndarë disa këshilla praktike lidhur me mënyrat dhe mekanizmat e mbrojtjes në rast rreziku nga tërmetet, përmytjet, kantjerët e ndërtimit, etj.

Projekti “Për një Mjedis dhe Zhvillim të qëndrueshëm: Mendo SAFE - Organizo SAFE - Vepro SAFE” po zbatohet nga Instituti Shqiptar për Çështjet Publike, me mbështetjen e [Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile - AMSHC](#)



**24 Prill 2023 Organizohet Takimi Kombëtar i Shoqërisë Civile** me qëllim identifikimin e prioritetëve tematike për secilën fushë veprimi të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile

(KKSHC) si dhe artikulumin e pritshmërive mbi rolin e KKSHC-së për vitin 2023 me fokus të shtuar, rolin dhe kontributin e shoqërisë civile në procesin e negociatave dhe më gjerë.

Objektivat e Takimit:

- a) Të ofrojë mundësinë e dialogut dhe shkëmbimit të eksperiencave mbi veprimtarinë dhe sfidat e shoqërisë civile në vend përmes një procesi pjesëmarrjeje nga poshtë lart;
- b) Të përfshijë, koordinoj dhe unifikojë zërin e shoqërisë civile përmes takimit fizik dhe online me anë të punës në grupe tematike.



**N J O F T I M Shpallet Thirrja Nr. 16 PËR Projekt- Propozime (27 Mars – 27 Prill 2023):**

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut; shpalli Thirrjen Nr. 16 për Shprehje Interesi për të gjitha OJF-të e interesuara për projekte.

OJF-të duhet të sjellin dosjen me dokumentat shoqëruese së bashku me projekt-propozimin me postë (merret në konsideratë data dhe ora e dorëzimit të aplikimit në postë) si dhe dërgimin e formularit të Aplikimit në formatin Word në add: [info@amshc.gov.al](mailto:info@amshc.gov.al), pranë zyrave të AMSHC-së në adresën: Rruga “Frosina Plaku”, Nr. 58, Godina e Observatorit, Kati II, Tiranë.

## KAPITULLI VI

### BORDI MBIKQYRËS

Bordi mbikqyrës për të përbushur detyrat sipas kompetencave të përcaktuara shprehimisht në ligjin Nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, gjatë vitit kalendarik 2023 ka bërë pjesë të mbledhjeve të organizuara nga ai në rendet e ditës të të cilave diskutohen një sërë objektivash dhe merren vendime. Në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023, janë shqyrtuar nga ana e Bordit Mbikqyrës 141 projekt-propozime, prej të cilave janë mbështetur me grante 65 OJF dhe nuk janë miratuar 76 projekt-propozime për mungesa të dokumentacionit tekniko-ligjor, ose për shkak se kërkesat e tyre financiare nuk përputheshin me prioritetet e paracaktuara nga Bordi Mbikqyrës.

Gjatë mbledhjeve të mbajtura të Bordit Mbikqyrës në vitin 2023 i është dhënë një vëmendje e veçantë dhe është trajtuar në mënyrë të vazhdueshme implementimi i sistemit elektronik e-Albania për të bërë të mundur reduktimin e dokumentacionit që është pjesë e aplikimit, duke e siguruar një pjesë të tij me bashkëpunim ndërinstytucional midis AMSHC-së dhe organeve tatimore, etj. Duke u bërë i mundur aplikimi ndërmjet sistemit elektronik e-Albania , mbështetur në ligjin 43/2023 “Për qeverisjen elektronike” konkretisht Neni 11 “Detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private në ofrimin e shërbimeve elektronike”, ju jepet mundësia subjekteve që plotësojnë kushtet ligjore të aplikojnë jo më duke dorëzuar fizikisht dokumentacionin pranë AMSHC-së.

Në bashkëpunim me AKSHI-in, AMSHC ka arritur të ndërtojë sistemin, i cili për shkak se nuk ka përfunduar procedura nga ana e AKSHI-it nuk arriti të materializohet dhe konkretizohet brenda vitit 2023 dhe do të punohet në vazhdimësi që të bëhet i mundur implementimi i tij sa në shpejt.